

RINJOFTIM

PËR ZHVILLIMIN E PROCEDURËS KONKURUESE PËR MARRJE AMBIENTI ME QIRA PËR KOPSHTIN PRANË SHKOLLËS 9-vjecare "MET HASA", NJËSIA ADMINISTRATIVE NR.4 , BASHKIA DURRËS.

Rinjoftim për zhvillimin e procedurës konkurruese për marrje ambienti me qira për kopshtin pranë shkollës 9-vjecare "Met Hasa" njësia administrative nr.4, Bashkia Durrës nga data 17.03.2025 me qëllim përmbushjen e detyrave dhe funksioneve administrativo-funksionale.

A. Kriteret, specifikimet e ambientit dhe dokumentacioni që kërkohet nga ofertuesi qiradhënës.

- Sipërfaqe jo më të vogël se 60 m² (hapësira dhome e fëmijëve min 30 m² +banjo funksionale min 5m² +amb.ndihmës)
- Të pozicionohet afër zonës së banimit dhe të jetë lehtësisht e aksesueshme nga popullata e interesuar për shërbimin.
- Të jetë i pozicionuar në katin mbi tokë.
- Ambienti i jashtëm oborri (nëse disponohet) të jetë i rrethuar që të garantojë siguri tek fëmijët.
- Aksesimi në kopësht të jetë i vecantë ,i destinuar vetëm për fëmijët .
- Të jetë i pozicionuar në një zonë të aksesueshme nga mjetet zjarrfikëse.
- Sistemi i furnizimit me ujë dhe energji elektrike të jetë në funksion të pandërprerë dhe kapacitet për të përballuar ngrohje-ftohjen.
- Ndricimi elektrik të jetë i përshtatshëm
- Të mundësojë ndricim dhe ajrim natyral.
- Dyshemeja e objektit të jetë material jo rrëshqitës
- Materiali I godinës rezistent ndaj zjarrit.

Vlera e qirasë nuk duhet të jetë më e vogël se 202.5 lekë/m² dhe 141.75 lekë/m² (sipërfaqe ndërtesë) për dërtesa të privatizuara me ligjin 7652 datë 23.12.1992"Për privatizimin e anesave shtetërore"

Dokumentacioni i kërkuar i cili do të jetë pjesë integrale e ofertës:

- Kërkesa e individit/subjektit për pjesëmarrje në konkurim.
- Kopja e dokumentit të identifikimit.
- Certifikata e pronësisë , ku të jetë specifikuar ambienti që do të jepet me qira, si dhe të jetë përcaktuar qartë sipërfaqja në m².Ky dokument të shoqërohet me kartelë të rifreskuar të pasurisë së paluajtshme ,hartë treguese dhe planimetri të detajuar të ambientit që do te jepet me qira.

- Deklarata e hollësishme e ofertuesit për vënien në funksionim të objektit, për veprimtarinë kërkuar.
 - Përshkrimi i ambientit shoqëruar me foto .
 - Oferta me vlerën mujore të qirasë (cmimi/m2)
 - Akti administrativ zyrtar që objekti rezulton i rregullt nga ana inxhinierike dhe ndërtimore si dhe akt konstatimin që rezulton i banueshëm (nga Njësia Administrative Ishëm).
 - Libreza e kontratës së energjisë elektrike dhe ujit, ose një faturë të lëshuar përkatësisht nga FSHU dhe UKT) në emër të aplikuesit.
 - Vërtetimi nga institucioni përkatës që subjekti nuk ka detyrime të papaguara të energjisë elektrike dhe furizimit me ujë, në lidhje me kontratat për furnizimin e objektit që do të jepet me qira.
 - Vërtetime nga institucionet përkatëse që : nuk është në ndjekje penale, nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, nuk është i dënuar / nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës së formës së prerë dhe nuk ndodhet në proces gjyqësor civil .
-
- Nëse ofertuesi është subjekt fizik /juridic
 - Vërtetimi që nuk është dënuar për ndonjë vepër penale në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë
 - Vërtetimi që nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me eprimtarinë.
 - Dokument që vërteton se subjekti nuk ka detyrime ndaj organeve tatimore.
 - Të gjitha dokumentat duhet të jenë në emër të aplikuesit.

B. Kohëzgjatja minimale 12 muaj –nga momenti i lidhjes se kontrates.

C. Dokumentacioni duhet të jetë origjinal ose fotokopje e noterizuar dhe duhet të jetë lëshuar brenda tre muajve të fundit . Dokumentacioni duhet dorëzuar pranë zyrës së Marëdhënieve me Publikun, deri me datë 02.04.2025 ora 10:00.